



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



NJOFTIM

DISKUTIM PUBLIK - SHQYRTIMI I RREGULLAVE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në faqen elektronike të saj www.ero-ks.org ka vendosur në diskutim publik:

draft Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë;

draft Rregullën për shqyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe

draft Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OSSH

Rregulla për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë përcakton kushtet dhe procedurat për parashtrimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë, si dhe zgjidhjen e kontesteve ndërmjet të licencuarve të energjisë.

Rregulla për shqyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë përcakton termat, kushtet dhe procedurat në lidhje me shqyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë. Rregulla vendos kriteret me anë të të cilave ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë dhe rikyçë konsumatorët dhe vendos standarde, parime dhe procedura të aplikueshme në lidhje me shqyçjen dhe rikyçjen në rrjet.

Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OSSH (Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) përcakton Bazën për vlerësimin e të hyrave të lejuara maksimale që OSSH mund të përfitojë në një vit relevant, në mënyrë që të mbulojë kostot e arsyeshme të zhvillimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes për konsumatorët në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Gjithashtu kjo rregull përcakton procesin sipas të cilit të hyrat e lejuara maksimale do të shqyrtohen dhe do të ripërcaktohen periodikisht dhe azhurnimet e rregullta vjetore si dhe ngarkesat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes ("DUOS"), të cilat përdoren për të mbuluar të hyrat e lejuara maksimale dhe taksat për kyçje të aplikuara nga OSSH.

ZRRE fton të gjitha palët e interesuara që të dërgojnë komentet e tyre në lidhje me këto rregulla, deri me 26 janar 2017, në adresën elektronike info@ero-ks.org. Ose në adresën postare Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë